

FUNCTIONAL CORRELATIONS BETWEEN PHRASES AND SENTENCE ELEMENTS

Dervish ALIM

University of Tetova, Faculty of Philology, English Language and Literature

dervish.alimi@unite.edu.mk

UDC 81'367

Conference paper

Abstract

Usually, the structural syntax studies the phrase-s as a group of words pronounced altogether and conveying a message or an information about: the doer of action that is preceding the predicator (NP), the action itself (VP) and the object of action (NP), that is following the predicator as well as the information about the circumstances of the action (PP, Adv.P), etc. On the other hand, the functional syntax studies the sentence elements which are also conveying similar messages or information. Thus, the subject consists of the NP and is placed before the predicator, whereas the Object is also a NP, but placed after the predicator.

The Predicator as a heart or nucleus of the sentence is in the same time a VP, describing the action of the doer and/or his situation. The PP is usually an Adjunct, because it gives information about the circumstances of time, place and manner in which the action occurs. The adjective phrase as a special independent phrase is usually in the position of the Subject complement, because it gives the description of the subject as a doer of action. Conclusively there is a functional correlation between the phrases as groups of words containing information about the participants in the event and the sentence elements as constituents of the sentence.

Key words: *Headwork, modifier, subject, predicator, subject complement object, complement, adjunct, etc.*

Përmbledhje

Zakonisht, sintaksa strukturore e studion togfjalshin si një grup fjalësh të shqiptuara me një frymë(marrje) që përcjell një mesazh ose një informacion të caktuar: bërësit të veprimit që i paraprin kallëzuesit (TE), vetë veprimin apo gjendjen e vepruesit (TF) dhe objektin e veprimit (TP), që pason kallëzuesin, si dhe informacionin rreth rrethanave të veprimit apo ngjarjes (PP, Adv.P), etj. Nga ana tjetër, sintaksa funksionale analizon elementet (gjymtyrët) e fjalisë, të cilat gjithashtu përcjellin mesazhin ose informacionin e ngjashëm.

Kështu, kryefjala përbëhet nga TE dhe është e vendosur para kallëzuesit, ndërsa kundrina është gjithashtu TE, por është e vendosur pas kallëzuesit. Kallëzuesi si zemër ose bërthamë e fjalisë është në të njëjtën kohë një TF, duke e përshkruar veprimin e bërësit dhe /ose gjendjen e tij. TP është zakonisht një rrethanor, sepse ai jep informacion rreth rrethanave të kohës, vendit dhe/apo mënyrës në të cilën ndodh veprimi. Togfjalëshi mbiemëror si një togfjalësh i veçantë i pavarur zakonisht është në pozicionin e Plotësit të kryefjalës, sepse ai jep përshkrimin e kryefjalës si bërës i veprimit. Konkluzivisht, ekziston një korrelacion funksional midis togfjalëshve si grupe fjalësh që përmbajnë informacion rreth pjesëmarrësve në ngjarje dhe elementet e fjalisë si përbërës të fjalisë.

Fjalët kyçe: *Fjala kryesore, modifikuesi, kryefjala, kallëzuesi, plotësi i kryefjalës, plotës i kundrinës, rrethanor, etj.*

Hyrje

Togfjalëshi mbiemëror si një togfjalësh i veçantë i pavarur zakonisht është në pozitën e plotësit të kryefjalës, sepse ai jep përshkrimin e subjektit si bërës të veprimit. Ekziston një korrelacion funksional midis togfjalëshve si grupe fjalësh që përmbajnë informacione rreth pjesëmarrësve apo protagonistave të ngjarjes dhe elementeve (=gjymtyrëve) të fjalisë si përbërës sintaksorë të fjalisë.

Ata që janë të njohur me analizën e diagramit të togfjalëshit si dhe fjalëve kryesore dhe modifikuesve të tij, janë fuqimisht dhe shumë mirë të kualifikuar për të identifikuar elementet e fjalisë, si: Subjekti/kryefjala jep informacion për bërësin e veprimit, kallëzuesi (Predicater) që është folja kryesore brenda klauzolës (=sifjalisë) apo fjalisë informon për vetë veprimin apo situatën e protagonistit, pastaj kundrina e drejtë dhe e zhdrejtë, janë objekte të veprimit të transmetuar, dhe rrethanori shpreh rrethanat në të cilat ndodh veprimi apo ngjarja. Të gjithë këta elementë të fjalisë janë përbërësit sintaksorë të pesë modeleve bazë të fjalisë, në gjuhën angleze.

I. FUNKSIONET E TOGFJALËSHIT EMËROR

1. Subjekti-Kryefjala si element-gjymtyrë i/e fjalisë

Emrat dhe togfjalëshi emëror funksionojnë si subjekt. Subjekti është një fjalë, frazë ose klauzolë (=sifjali) e cila kryen veprimin ose është në një situatë të caktuar. Klauzolat dhe fjalitë përmbajnë së paku një subjekt dhe një kallëzues.

Togfjalëshat e nënvizuar në vijim janë shembuj të subjektit.

- The green house is for sale.
- Shtëpia e gjelbër është në shitje.
- Flowers are taking over the balcony.
- Lulet po e marrin ballkonin.
- The baby cried.
- Fëmija qau.
- Fish and birds make excellent pets.
- Peshqit dhe shpendët bëjnë kafshë shtëpiake të shkëlqyeshme.

Edhe forma të tjera gramatikore madje edhe fjali të tëra mund të funksionojnë si subjekte, por emrat dhe togfjalëshat emërorë janë ata që kryejnë më së shpesh atë funksion.

2. Plotësi kryefjalor (Subject Complement)

Emrat dhe togfjalëshat emërorë funksionojnë edhe si plotës kryefjalor. Një plotës kryefjalor është një fjalë, frazë ose klauzolë që ndjek një folje kopulare ose lidhëse dhe e përshkruan subjektin.

Togfjalëshat e nënvizuar në vijim janë shembuj të plotësve kryefjalorë:

- The woman was a nurse.
- Gruaja ishte një infermiere.
- Her sister will become the school librarian.
- Motra e saj do të bëhet bibliotekare e shkollës.
- My grandfather is a farmer.
- Gjyshi im është fermer.
- My friend is a doctor.
- Miku im është mjek.

3. Kundrina e drejtë (Object)

Emrat dhe togfjalëshat emërorë mund të funksionojnë edhe si kundrinë e drejtë. Një kundrinë e drejtë është një fjalë, frazë ose klauzolë që ndjek një folje kalimtare (transitive verb) dhe i përgjigjet pyetjes "kë?" për njerëz apo "çka/çfarë?" për sende, dhe e pranon apo pëson veprimin e foljes apo kallëzuesit. Prandaj, folja duhet të jetë kalimtare në mënyrë që të pranojë kalimin e veprimit si objekt i veprimit, duke zëvendësuar në këtë mënyrë rasën e mëparshme kallëzuese.

Togfjalëshit e nënvizuar në vijim janë shembuj të kundrinave të drejta:

- Dogs eat meat.
- Qentë hanë mish.
- The child finally swallowed the sweet-tasting cream.
- Fëmija më në fund e gëlltiti kremin me shije të ëmbël.
- The children ate all the cookies.
- Fëmijët i hëngrën të gjitha ëmbëlsirat.
- The woman hasalëyshated insects and rats.
- Gruaja gjithmonë i ka urryer insektet dhe minjtë.

4. Plotësi kundrinor (Object complement)

Në mënyrë të ngjashme me plotësin e kryefjalës, emrat dhe togfjalëshit emëror mund të funksionojnë edhe si plotës të kundrinës. Një plotës kundrinor është një fjalë, frazë ose klauzolë që drejtpërdrejt pason dhe përshkruan kundrinën e drejtë.

Togfjalëshit e nënvizuar në vijim janë shembuj të plotësve kundrinorë:

- We elected **you** team leader.
- Ne ju kemi zgjedhur **ju-ve** udhëheqës të ekipit.
- My sisters named **my daughter** Autumn!
- Motrat e mia e quanin **vajzën time** Vjeshtë!
- America recently elected **Donald Trump** president.
- Amerika kohët e fundit e ka zgjedhur **Donald Trumpin** president.
- My uncle calls **my aunt** sweetheart.
- Ungji im e thërret **tezen time** sheqerkë.

5. Kundrina e zhdrejtë (Indirect Object)

Emrat dhe togjalëshit emërorë mund të funksionojnë edhe si kundrinë e zhdrejtë. Një kundrinë e zhdrejtë është një fjalë, frazë ose klauzolë që pason një folje jokalimtare dhe përgjigjet në pyetjen "kujt ose për kë?" ose "për çka ose për çfarë", dhe është objekt i tërthortë i veprimit të foljes së kryer. Folja duhet të jetë dykalimtare (ditranstive) në mënyrë që të fitojë dhe të zëvendësojë rasën e mëparshme dhanore.

Togjalëshat e nënvizuar në vijim janë shembuj të kundrinave të zhdrejta:

- My sister loaned me a book.
- Motra ime më ka huazuar një libër.
- She gave me a gift.
- Ajo më dha një dhuratë.
- The child drew his mother a picture.
- Fëmija i vizatoi nënës së vet një figurë.
- Let her have it!
- Lejoja (asaj) le ta merr atë.

II. FUNKSIONI I TOGFJALËSHIT FOLJOR

1. Kallëzuesi

Togfjalëshi foljor në kuptimin e ngushtë të fjalës përbëhet ekskluzivisht nga foljet, edhe atë: **ndihmëse** (kam dhe jam) ose **modale** në pozicionin e paramodifikuesit (premodifier), dhe nga foljet **leksike** si fjalë kryesore (headëord). Ata zakonisht janë në funksion të **kallëzuesit** brenda fjalisë. Prandaj, ata që janë të njohur me këto lloje të foljeve, supozohet që të jenë të aftësuar të identifikojnë fjalët që janë në funksion të kallëzuesit, në çdo lloj fjalie, qoftë të thjeshtë apo të zgjeruar, si dhe përbrenda klauzolave (sifjalive) që formojnë një fjali të përbërë ose komplekse, gegjësisht të a.q. periudhë.

Togfjalëshit e nënvizuar foljorë janë shembuj të kallëzuesve:

- They must have done it before!
- Ata duhet ta kenë bërë këtë më parë!
- She has had plenty of time to do this.
- Kur ka pasur shumë kohë për ta bërë këtë.
- I really did pass the exam last session.
- Unë me të vërtetë e kalova provimin e sesionit së fundit.
- Have you ever done this before?
- A e keni bërë ndonjëherë këtë më parë?

III. FUNKSIONET E TOGFJALËSHAVE MBIEMRORË

1. Plotësi kryefjalor (Subject complement)

1. Togfjalëshi mbiemëror zakonisht e pason një folje **ndërlidhëse** (linking verb), që don të thotë se përshkrimi burimor i kryefjalës bëhet në mënyrë të tërthortë, pra përmes një folje ndërlidhëse, gjegjësisht linking verb ("jam" dhe variacionet e saj semantike dhe stilistike: become, look, feel, seem, resemble, get, etc.).

Togfjalëshit e nënvizuar janë shembuj të plotësit të kryefjalës:

- The students **are** /very/ hardworking
- Nxënësit **janë** / shumë / të zellshëm
- Our school building **is** extremely old.
- Ndërtesa e shkollës **është** jashtëzakonisht i vjetër.
- The baby is very cute.
- Foshnja është shumë e bukur (e lezetshme).
- Our parents **are** very happy!
- Prindërit tanë janë shumë të lumtur!

2. Plotësi kundrinor (Object complement)

Togfjalëshi mbiemëror mund të pasojë edhe një përemër vetor ose një emër, duke e përshkruar cilësinë e tij, edhe pse kjo formë është statistikisht shumë e rrallë, sidomos në gjuhën shqipe, ku ky model i fjalive, krahasuar me gjuhën angleze, është i pazakonshëm.

Togfjalëshit e nënvizuar mbiemërorë janë shembuj të plotësve kundrinorë:

- He made **her** happy.
- **E** bëri (**atë**) të lumtur.
- They find **syntax** very interesting.
- Ata e gjejnë **sintaksën** shumë interesante.
- I'll have **my car** washed.
- Unë do të çoj **makinë** time ta lajnë
- I'll have **my hair** cut.
- Do të skoj t'i shkurtoj **flokët.**

IV. FUNKSIONET E TOGFJALËSHIT NADJFOLJOR

1. Rrethanori

Togjalëshi ndajfoljor zakonisht është një rrethanor në sintaksën funksionale. Prandaj, ndajfoljet edhe nga kuptimi burimor ad + folje, janë të vendosura pranë foljes që zakonisht përshkruan një veprim, ose një situatë, dhe rrjedhimisht, ndajfoljet dhe togfjalëshit ndajfoljorë japin informacion për rrethanat e ngjarjes (apo veprimin ose situatën) në të cilat ndodh apo gjendet veprimi. Folja duhet të jetë **jokalimtare** në mënyrë që më pas të pasojë një ndajfolje. Togfjalëshit ndajfoljorë të nënvizuar më poshtë janë shembuj të rrethanorit:

- He **reads** too much!
- Ai **lexon** shumë (për tepër)!
- You **work** very hard.
- Ti **punon** shumë zellshëm.
- Pull over** here.
- **Hape krahun** (ndale veturën) këtu.
- Don't **wait** for me any more.
- Mos **prisni** më për mua.

V. FUNKSIONET E TOFJALËSHIT PARAFJALOR

1. Rrethanori

Togjalëshi parafjalor është gjithashtu një rrethanor në sintaksën funksionale. Ai zakonisht gjendet pas togfjalëshit foljor, i cili zakonisht përshkruan një veprim, ose një situatë. Si pasojë, edhe togfjalëshit parafjalorë japin informacione rreth rrethanave në të cilat ndodh veprimi ose është situata. Folja duhet të jetë **jokalimtare** në mënyrë që të pasojë një togfjalësh parafjalor.

Togfjalëshit parafjalorë të nënvizuar në vijim janë shembuj të rrethanorit:

- The children **are playing** in the schoolyard.
- Fëmijët **luajnë** në oborrin e shkollës.
- We are travelling **all over** the world.
- Ne po **udhëtojmë** në mbarë botën.
- They **don't make any noise** during the classes.
- Ata nuk **bëjnë zhurmë** gjatë orëve të mësimin.
- You **need to treat** me with respect.
- Duhet të më **trajtoni** me respekt.

2. Kundrina parafjalore (Prepositional object)

Togfjalëshat parafjalorë funksionojnë edhe si kundrinë parafjalore (=me parafjalë). Një kundrinë parafjalore është një fjalë, frazë ose klauzolë që përbëhet nga një parafjalë dhe një togfjalësh emëror. Kundrina parafjalore e zëvendëson drejtpërdrejt rasën e mëparshme rrjedhore, ose rasën e vjetër instrumentale.

Togfjalëshit parafjalorë të nënvizuar në vijim janë shembuj të kundrinës me parafjalë:

- That little girl brought a toy **for his baby sister.**
- Kjo vajzë e vogël solli një lodër **për motrën e fëmijës.**
- My friends bought flowers **for me.**
- Miqtë e mi bleu lule **për mua.**
- I have been waiting **for you** a long time.
- Kam pritur **për ty** shumë kohë.
- I have never been **against you.**
- Kurrë s'kam qenë **kundër teje.**

Përfundimi

Funkcionet e përmendura të togfjalëshave nuk janë të vetmit, sepse nganjëherë ata ndërthuren dhe vija e ndarjes ndërmjet tyre nuk është shumë e rreptë. Ne vetëm po përqipemi të dallojmë rastet më të shpeshta të funksioneve të një togfjalshi të caktuar, duke theksuar se kjo varet nga lloji i foljes që përdoret në fjali ose në klauzolë, dhe që rezulton si pasojë e pyetjeve më të zakonshme të a.q. magjike, që përdoren për të pyetur për marrëdhëniet midis fjalëve.

Në fakt, ata që janë në gjendje të parashtrajnë pyetjet e duhura në mënyrë që të vijnë në përgjigjen e nevojshme, supozohet se kanë kapërcyer gjysmën e rrugës dhe janë të kualifikuar për të notuar dhe kaluar gjysmën e dytë të rrugës në detin ose oqeanin e pafund të fjalëve, të cilat janë komplekse, por nuk është e vështirë t'i lidhim. Pjesa tjetër varet nga interesi dhe puna e madhe që ata janë të gatshëm të bëjnë për të zotëruar disiplinën e sintaksës funksionale, siç është rasti në fakt në të gjitha disiplinat shkencore.

Bibliografia

André Martinet (1960). Elemente të Sintaksës Funktionale, FJALA, 16: 1, 1-10,

Gramatika Moderne Shqiptare, Diana Blagajne, etj.

Gramatika e gjuhës shqipe, ASHA, Tiranë,

<https://www.colorado.edu/linguistics/research/functional-syntax>

<http://hpsg.stanford.edu/papers/Kuno1987-ch1.pdf>

www.cambridge.org> ...> Akademik> Gjuhët dhe gjuhësia> Gramatika dhe sintaksë

darkwing.uoregon.edu/~delancey/sb/functional_syntax.doc

Gramatika e Gjuhës Shqipe, Vëllimi II, Sintaksa by Mehmet Celiku, Mahir Domi, Spiro Floqi, etj.